

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova / Republic of Kosovo**  
**Qeveria / Vlada / Government**  
**Ministria e Punëve të Brendshme / Ministarstvo Unutrasnjih Poslova / Ministry of Internal Affairs**  
*Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik*  
*Odeljenje za upravljanje javnim službenicima-Department for the Management of Public Officials*

Nr. 112  
Datë: 25 / 01 / 2024

Në mbështetje të nenit 53 ndërlidhur me nenin 55 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, nxjerrë këtë:

**V E N D I M**  
**për anulimin e procedurave të rekrutimit për specialistë të arsimit**

- I. Anulohen procedurat e rekrutimit me RN00011609 SIA Prishtinë, RN00011610 SIA Mitrovicë, RN00011607 SIA Prizren, RN00011608 SIA Pejë, RN00011612 SIA Gjakovë, RN00011611 SIA Gjilan, RN00011613 SIA Ferizaj për pozitën "Specialist i Arsimit" të shpallura nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/Ministria e Punëve të Brendshme me datë 05.05.2023.
- II. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Arsyetim**

Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik (DMZP) me datë 05.05.2023 ka publikuar shpalljet për procedurat e rekrutimit për specialistë të arsimit. Me datë 12.09.2023 Divizioni për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit ka shpallur listat e kandidatëve fitues për të gjitha procedurat.

Me datë 27.12.2023 DMZP ka pranuar Vendimet e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil (KOMSHC) për procedurat në SIA Prishtina dhe SIA Mitrovicë, me datë 04.01.2024 për procedurat SIA Gjakovë dhe SIA Prizren, me datë 05.01.2024 për SIA Gjilan dhe me datë 10.01.2024 SIA Ferizaj dhe SIA Prizren, me të cilët është obliguar DMZP që të anulojë vendimin e datës 12.09.2023 të Komisionit të Pranimit në Institucionet e Administratës Shtetërore, njoftimin e datës 12.09.2023 të DMZP për shpalljen e kandidatëve fitues si dhe çdo veprim tjetër administrativ të ndërmarrë nga faza e verifikimit paraprak deri në publikim e Njoftimit të datës 12.09.2023 dhe ka kthyer çështjen në ri-shqyrtim dhe ri-vendosje në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik.

DMZP pas pranimit të Vendimeve nga KPMSHCK, ka publikuar njoftimet për kthimin e procedurave në fazën e verifikimit paraprak. Megjithatë, gjatë fazës së verifikimit, janë hasur probleme të cilat e bëjnë të pamundur vazhdimin e fazës së verifikimit paraprak dhe

rrjedhimisht edhe fazave pasuese të përcaktuara në Rregulloren Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. Kjo pasi që gjatë shpalljes së procedurave më datë 05.05.2023, tek pika 3 e shpalljes “*kërkesat e përgjithshme formale*” përveç diplomës së arsimit të lartë dhe përvojës së punës së paku dy (2) vite në fushën përkatëse është përcaktuar si kriter edhe “*licenca e mësimdhënësit të kualifikuar në përputhje me nenin 34 të Ligjit Nr. 04/L-032 për Arsimin e Parauniversitar në Republikën e Kosovës*”. Megjithatë, tek pika 7 e shpalljes, ku është listuar dokumentacioni i cili duhet të paraqitet për aplikim, mungon kërkesa për të paraqitur dëshminë se aplikuesi posedon licencë të vlefshme të mësimdhënësit, siç është përcaktuar tek kriteret formale, ndërsa janë kërkuar kopjet e diplomave, kopjet e dëshmisë së punësimit, trajnimeve, dhe certifikatës/vërtetimit se aplikuesi nuk është i dënuar.

Gjithashtu, shpallja e procedurës së rekrutimit përveç në ueb faqen e procedurave të konkurrimit (SIMBNJ), në përputhje me nenin 9 të Rregullores 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën, është publikuar edhe në ueb faqen e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe në atë të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit. Megjithatë, në ueb faqen e Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit ka mbetur e publikuar shpallja e konkursit në të cilën nuk është përcaktuar fare licenca e mësimdhënësit si kërkesë e përgjithshme formale.


Si pasojë e kësaj, për aplikuesit nuk ka qenë e qartë nëse licenca e mësimdhënësit është kërkesë formale apo jo, dhe nëse duhet të bashkëngjitet dëshmia se posedon licencë të vlefshme në momentin e aplikimit. Si rrjedhojë, nga numri i përgjithshëm i aplikuesve në shtatë procedurat e rekrutimit, vetëm një numër i vogël i aplikantëve kanë bashkëngjitur licencën në momentin e aplikimit.

Për më tepër, siç është konstatuar edhe në vendimet e lartcekura të KPMSHC-së, pas shpalljes së procedurës së rekrutimit, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ka Miratuar Udhëzimin Administrativ (MASHTI) Nr. 14/ 2023 për Sistemin e Licencimit dhe Karrierën në Mësimdhënie. Miratimi i këtij udhëzimi, gjatë periudhës në të cilën ka qenë në proces procedura e rekrutimit ka shkaktuar ndryshim të sistemit të vlerësimit të licencave të mësimdhënësve.

Për këtë arsye, duke pasur parasysh se ndër parimet kryesor të Ligjit për Zyrtarët Publik janë parimi i mundësive të barabarta, meritës dhe integritetit, mosdiskriminimit dhe se pranimi kryhet nëpërmjet një procesi përzgjedhës profesional, transparent e të drejtë, që garanton mundësi të barabarta për kushte të barabarta dhe përzgjedhjen e kandidatëve më të kualifikuar për kryerjen e detyrave përkatëse, DMZP konsideron se problemet në shpalljet e lartcekura e bëjnë të pamundur vazhdimin e procedurave të rekrutimit në përputhje me këto parime.

Prandaj, me qëllim të adresimit të detyrimit për të vendosur ligjshmërinë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Qëndrim Bytyqi



Ud. Drejtor i Departamentit  
për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik

